

MINISTRIA E BRENDSHME
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
KORRIK - SHTATOR 2024

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
21	22.07.2024	Kërkesë për info nga një Qendër për Shkencë, Inovacion dhe Zhvillim në lidhje me të dhëna për projektin “Smart City”.	30.07.2024	Projekti “Smart City” parashikon instalimin dhe shtrirjen e mbi 4.500 APNR kamerave fikse të sigurisë së jashtme, kamerave për lexim automatik të targave të automjeteve të ndërlidhura mes tyre, nëpërmjet të cilave do të realizohet monitorimi dhe identifikimi në kohë reale i mjeteve që qarkullojnë në akset rrugore të cilësuar me interes prioritar për Policinë Rrugore, të Rendit, Policinë Kriminale, si dhe në Pikat Kufitare; gjithashtu janë parashikuar radarë e tableta smart, si dhe kamera trupi për punonjësit e policisë. Projekti do të shtrihet në 20 qytetet kryesore në vend, si Tirana, Durrësi, Vlorë, Fieri, Shkodra, Lezha, Korça, etj., si dhe në zonat turistike me më shumë fluks vizitorësh. Ky projekt, zbatimi i të cilit punohet për të nisur në një kohë sa më të shpejtë, synon rritjen e sigurisë në komunitet, mbrojtjen e jetës dhe të pronës private, monitorimin e trafikut etj. përmes një sistemi	E plotë	Nuk ka

				gjithëpërfshirës zgjidhjesh teknologjike. Në funksion të tij, janë zhvilluar disa takime prezantuese e njohëse me detajet, ku përmendim më të fundit atë të mbajtur në Ministrinë e Brendshme në Tiranë, në qershor 2024, ku Ministri i Brendshëm Taulant Balla, së bashku me drejtues të lartë të Policisë së Shtetit ndoqën një prezantim nga përfaqësuesit e Emirateve e Bashkuara Arabe të projektit përfundimtar “Smart City”.		
22	12.08.2024	Kërkesë nga një shtetas për kopje të raporteve të auditimit në institucionin e Prefektit të qarkut Kukës, për vitet 2018 - 2021	27.08.2024	Bashkëlidhur ju dërgojmë kopje të raporteve të auditimit në institucionin e Prefektit të qarkut Kukës, për periudhat 01.09.2018 - 01.09.2019 dhe 01.09.2019 - 31.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Auditit në Ministrinë e Brendshme në formatin e kërkuar prej jush.	E plotë	Nuk ka
23	15.10.2024	Kërkesë nga një gazetar i një rrjeti investigativ për kopje të marrëveshjes për projektin Smart city” mes Shqipërisë dhe EBA.	21.10.2024	Në datën 23 prill 2024 Ministri i Brendshëm, z. Taulant Balla zhvilloi një vizitë zyrtare në Emiratet e Bashkuara Arabe me homologun e tij z. Saif bin Zayed Al Nahya, ku u diskutua mbi çështjet e bashkëpunimit dypalësh në fushën e krimit të organizuar dhe sigurisë.	E plotë	Nuk ka

				Në kuadër të bisedimeve lidhur me çështjet e sigurisë, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për projektin “Smart City”, i cili përmes përdorimit të Inteligjencës Artificiale dhe Sistemit të Analizimit të të Dhënave, synon rritjen e efikasitetit dhe qëndrueshmërinë urbane, përmirësimin e sigurisë publike duke parandaluar dhe dokumentuar veprat penale nëpërmjet investimeve teknologjike. Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua bazuar në ligjin Nr. 145/2020 “Për Ratifikimin e Marrëveshjeve për Bashkëpunimin Ekonomik Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”. Duke respektuar termat e nënshkrimit dhe detyrimet që rrjedhin nga ky Memorandum Mirëkuptimi, konkretisht bazuar në nenin 7 të tij, “Konfidencialiteti, thuhet se: “Palët bien dakord që secila duhet t’i trajtojë në mënyrë konfidenciale termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje dhe të gjithë informacionin e		
--	--	--	--	---	--	--

				dhënë nga secila palë ndaj tjetrës lidhur me zhvillim e këtij projekti”, për këtë arsye e kemi objektivist të pamundur vendosjen në dispozicion të kopjes së kësaj marrëveshjeje. CC: Komisioneri për të Drejtën e Informimit		
--	--	--	--	--	--	--